



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Tiranë

Tel. 04 2268142; Fax 042268141

Nr. 36/9 Prot.

Tiranë, më 25.04. 2016

V E N D I M

Nr. 47, datë 25.04.2016

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ,
filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 36/1 prot., datë 22.01.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104, 121 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 35, të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit nr.82 prot., datë 20.04.2016 dhe mendimit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit lidhur me transferimin në kuadër të ristrukturimit, të punonjësës *****, në pozicionin *Specialist i Sektorit të Mbështetjes së Përdoruesve, Kateg. III-b*, në Drejtorinë e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Financave.

VËREJ:

Në zbatim të urdhrit nr. 36/1 prot., datë 22.01.2016, "Për verifikim informacioni", i cili ka dalë me qëllim verifikimin e një njoftimi të ardhur me shkresën me nr. 36 prot, datë 18.01.2016, për parregullsi të lejuara në mënyrën e emërimit pas ristrukturimit të nëpunësës *****, duke e caktuar atë në një pozicion pune ku nuk përmbushte kriterin arsimor, ka filluar hetimi administrativ duke kërkuar nga Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike gjithë dokumentacioni i nevojshëm. Pasi u shqyrtuan materialet e mbledhura gjatë procesit të hetimit administrativ, ka rezultuar se :

Me shkresën nr. 384/1 prot., datë 03.02.2016, "Kthim përgjigje", Departamenti i Administratës Publike, ka informuar Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, se pranë këtij institucioni është depozituar një ankim, ku është ngritur pretendimi se punonjësja *****

nuk plotëson kriterin e nivelit të arsimit në pozicionin ku është transferuar për shkak të ristrukturimit dhe se ky rast është në shqyrtim e sipër.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 14 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, nenit 78 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me vendimin nr. 18, datë 09.02.2016, *“Për pezullimin e procesit të verifikimit të rastit të transferimit të punonjësës *****, pranë Sektorit të Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Financave”*, Komisioneri vendosi pezullimin e procesit të verifikimit të filluar me urdhrin nr. 36/1 prot., datë 22.01.2016, në lidhje me transferimin e punonjësës *****, pranë Sektorit të Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Financave, deri në përfundimin e procedurës së shqyrtimit nga ana e Departamentit të Administratës Publike.

Departamenti i Administratës Publike pas përfundimit të procesit të shqyrtimit dhe rivlerësimit të këtij rasti, me shkresën me nr. 5641/6 prot., datë 23.03.2016, *“Kthim përgjigje në lidhje me rastin e *****”*, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, ka vënë në dijeni edhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me konkluzionet e arritura, duke përcaktuar edhe veprimet përkatëse që duheshin kryer nga administrata e Ministrisë së Financave për rregullimin e pasojave.

Për sa analizuam më sipër, u vlerësua se dokumentacioni, i cili u administrua në lidhje me këtë çështje, është i mjaftueshëm për të rifilluar hetimin administrativ, i cili ishte pezulluar me Vendimin e nr. 18, datë 09.02.2016, *“Për pezullimin e procesit të verifikimit të rastit të transferimit të punonjësës *****, pranë Sektorit të Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Financave”*.

Në këto kushte, duhet revokuar Vendimi i ndërmjetëm me nr. 18, datë 09.02.2016, *“Për pezullimin e procesit të verifikimit të rastit të transferimit të punonjësës *****, pranë Sektorit të Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Financave”* dhe të vazhdojë hetimi me shqyrtimin e çështjes administrative lidhur me transferimin e punonjësës ***** në pozicionin *Specialist i Sektorit të Mbështetjes së Përdoruesve*, në Drejtorinë e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Financave.

Nga shqyrtimi i akteve të administruara rezulton se, punonjësja ***** është punësuar në shërbimin civil, pasi është deklaruar fituese (me 80.8 pikë), në përfundim të procedurës së konkurrimit, kryer sipas kërkesave të nenit 23 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, për grupin e pozicioneve nr. 10 *“Lloji i diplomës shkenca kompjuterike/ informatikë/ elektronikë /matematikë/ fizikë, niveli minimal i diplomës Bachelor”*.

Në përfundim të kësaj procedure, me shkresën nr. 3496 prot., datë 07.11.2014 të Departamentit të Administratës Publike, ***** është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Specialist i Sektorit të Mbështetjes së Përdoruesve*”, në Drejtorinë e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Financave (kategoria IV-a).

Gjithashtu, Departamenti i Administratës Publike, bazuar, në nenin 24 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pikës 13, të kreut VI të VKM nr. 243, datë 18.03.2015, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhen e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, vendimin e eprorit direkt, rezultatin e testimit të ciklit të detyrueshëm të pranimit pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe vlerësimit të rezultateve individuale në punë, deklaron në përfundim të periudhës së provës, punonjësen ***** si nëpunës civil, në pozicionin *Specialist i Sektorit të Mbështetjes së Përdoruesve*, në Drejtorinë e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Financave.

Nga gjithë sa më sipër, konkludohet se procedura e pranimit në shërbimin civil dhe punësimi i punonjësës në fjalë është bërë në përputhje me ligjin në gjithë kërkesat e tij, duke përfshirë edhe nivelin arsimor, pasi në shpalljen e konkurrimit, siç është cituar edhe më sipër, si nivel arsimit, për pozicionin e lirë *Specialist i Sektorit të Mbështetjes së Përdoruesve*, në Drejtorinë e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, kërkohej vetëm diploma “*bachelor*” në atë fushë, gjë e cila justifikonte edhe nivelin e pagës në atë kohë.

Pas miratimit të strukturës së re të Ministrisë së Financave me Urdhrin e Kryeministrit nr. 45, datë 31.03.2015 “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave*”, në zbatim të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, me urdhrin e Departamentit të Administratës Publike nr. 27, datë 23.04.2015 “*Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Financave*”, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit i cili në përfundim të veprimtarisë së tij, me shkresën nr. 5606/2 prot., datë 11.05.2015 ka propozuar sistemimet e nëpunësve në pozicionet e mbetura, apo të riorganizuar, sipas strukturës së re.

Një nga këto propozime të Komisionit të Ristrukturimit ishte edhe kalimi i punonjësës ***** nga pozicioni i mëparshëm “*Specialist në periudhë prove në Sektorin e Mbështetjes së Përdoruesve*”, në Drejtorinë e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, (kategoria IV-a), në pozicionin *Specialist i Sektorit të Mbështetjes së Përdoruesve*, në Drejtorinë e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, (kategoria III-b).

Mbi bazën e këtij propozimi, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 1464/54, datë 05.06.2015, me lëndë “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, ka vendosur kalimin e punonjësës ***** në pozicionin *Specialist, në Sektorin e Mbështetjes së*

Përdoruesve në Drejtorinë e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Financave, kategoria e pagës III-b.

Nga analiza në tërësi e dokumentacionit dhe rrethanave të çështjes, vlerësohet se, Komisioni i Ristrukturimit i ngritur me urdhrin e Departamentit të Administratës Publike nr. 27, datë 23.04.2015 “*Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Financave*”, ka vepruar në kundërshtim me pikën 19 të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*”, ku është e përcaktuar se, në propozimin e tij mbështetet në kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara të reja si pasojë e ristrukturimit dhe të dhënat e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve preken si pasojë e ristrukturimit.

Në rastin konkret, pozicioni i mëparshëm i punës, pas ristrukturimit, megjithëse ka ruajtur të njëjtin emërtim “*Specialist, në Sektorin e Mbështetjes së Përdoruesve në Drejtorinë e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit*”, ka pësuar rritje në nivelin e pagës, duke e kaluar atë në kategorinë III-b, gjë e cila në kuptimin e specifikës së përshkrimit të punës, ky pozicion pas miratimit të strukturës së re dhe përshkrimit të ri të punës, kërkon diplomë “*Master Shkencor*”, pra një nivel më të lartë kualifikimi, se sa niveli i diplomës “*Bachelor*”.

Duke marrë në analizë gjithë sa u thanë më sipër, e duke e krahasuar këtë me të dhënat personale të nëpunëses, arrihet në përfundimin se marrëdhënia e punës në shërbimin civil e nëpunëses *****, në momentin e lidhjes së saj ka qënë e rregullt, pasi ajo ka plotësuar kërkesat e vendit të punës sipas dokumentit të shpalljes së konkurrimit dhe përshkrimit të punës të momentit, si dhe ka respektuar procedurën e pranimit në shërbimin civil.

E tillë ka vazhduar kjo marrëdhënie deri në momentin e kryerjes së ristrukturimit dhe transferimit për shkak të këtij ristrukturimi, në pozicionin “*Specialist, (kategoria III-b) në Sektorin e Mbështetjes së Përdoruesve në Drejtorinë e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit*”, me aktin nr. 1464/54 datë 05.06.2015 të Njësisë Përgjegjëse.

Por, nga kqyrja e mëtejshme e dokumentacionit, vërehet se në momentin e kryerjes së këtij transferimi, nëpunësja më fjalë nuk përmbushte kriterin e kualifikimit arsimor, pasi megjithëse në këtë kohë ishte në vazhdim e sipër të studimeve në nivelin master , nuk i kish përfunduar ato. Këtë kualifikim kjo nëpunëse, siç del nga përmbajtja e dokumentit nr. 09/2016 dt. 12.02.2016 “*Konfirmim i Studimeve*” të Universitetit UNYT Tiranë, e ka arritur në datën 31.01.2016, duke u diplomuar “*Master Shkencor në Shkenca Kompjuterike*”, konfirmuar kjo edhe nëpërmjet shkresës nr. 5641/6 prot., datë 23.03.2016 të Departamentit të Administratës Publike, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave.

Për sa konkludua më sipër, në momentin e verifikimit të këtij rasti jemi para faktit që, ndonëse në momentin e transferimit në datën 05.06.2015, punonjësja ***** nuk plotësonte kriterin

e nivelit arsimor për pozicionin e punës ku u transferua, tashmë e ka plotësuar atë, duke e kthyer marrëdhënien e punës në gjendje ligjshmërie të plotë.

Megjithatë, në momentin e hetimit të këtij rasti, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është vënë në dijeni të faktit se, punonjësja ***** ka përfunduar studimet e ciklit të dytë Master Shkencor në Shkenca Kompjuterike, konfirmuar kjo me shkresën nr. 5641/6 prot., datë 23.03.2016 të Departamentit të Administratës Publike drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, punonjësja ***** pas diplomimit e ka plotësuar kriterin minimal të diplomës për pozicionin aktual, sipas kërkesave të vecanta të pozicionit të punës, të përcaktuara në VKM nr. 142, datë 12.03.2014 *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, si rrjedhojë nuk jemi në kushtet e pavlefshmërisë absolute apo relative dhe për pasojë qëndrimi i Departamentit të Administratës Publike vlerësohet i drejtë.

Si përfundim, meqënëse aktualisht marrëdhënia e punësimit për nëpunësen ***** , *“Specialist, (kategoria III-b) në Sektorin e Mbështetjes së Përdoruesve në Drejtorinë e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit”*, i përmban në mënyrë të plotë të gjithë elementët përbërës të saj, arrihet në konkluzionin që në këtë rast duhet të rregullohet vetëm eliminimi i pasojave financiare që janë shkaktuar nga akti i transferimit nr. 1464/54 dt. 05.06.2015 i Njesisë Përgjegjëse.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, nenit 121 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe nenin 16 dhe 35, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të revokojë Vendimin nr. 18, datë 09.02.2016, *“Për pezullimin e procesit të verifikimit të rastit të transferimit të punonjësës ***** , pranë Sektorit të Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Financave”*.
2. Të kërkoj nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, të marrë masat për rregullimin e pasojave financiare dhe konkretisht nëpunëses ***** duhet ti mbahet diferenca e pagës ndërmjet kategorisë IV-a dhe III-b, për atë pozicion pune që ka mbuluar, për periudhën nga data 05.06.2015 deri në datën 31.01.2016.

3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë nga marrja dijani për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Të njoftohen për këtë vendim, Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA